

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Franca është një nga vendet evropiane me shkallën më të lartë të kundërshtimit popullor ndaj zgjerimit të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor. Po ku mbështetet ky kundërshtim, dhe sa e rëndësishme është çështja e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor për Francën? Ky raport, i cili përdor një kombinim të paraqitjes së të dhënave të studimit të vitit 2020 me popullsinë e rritur franceze dhe me fokus-grupe të thelluara votuesish francezë, ofron një panoramë gjithëpërfshirëse mbi këndvështrimin e francezëve nëse vendet e Ballkanit Perëndimor duhet t'i bashkohen BE-së apo jo. Rezultatet janë të rëndësishme për vendimmarrësit politikë si dhe aktorët e shoqërisë civile. Përfundimet tona më të rëndësishme janë:

1. Shumica e njerëzve në Francë kundërshtojnë bashkimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE-në, por për shumicën e tyre kjo çështje nuk është një çështje e spikatur dhe qëndrimet nuk janë shumë të ngurta.

Me afro 60% kundërshtim, shumica e të intervistuarve thanë se do të ishte disi keq ose shumë keq, nëse Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia do t'i bashkoheshin BE-së. Megjithatë, më pak sesa një e treta thanë se zgjerimi i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor do të prekte jetët e tyre shumë ose të paktën disi, dhe pothuajse gjysma ndryshuan këndvështrim mbi çështjen, në varësi të faktit nëse u pyetën rreth rajonit në përgjithësi apo për shtete specifike. Kjo tregon që për shumicën e njerëzve në Francë, zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor nuk është çështje e spikatur dhe pikëpamjet mbi këtë temë nuk janë shumë të ngurta.

2. Qëndrimet mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor pasqyrojnë më tepër pikëpamjet e përgjithshme mbi BE-në, sesa stereotipet ose shqetësimet specifike ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Midis të intervistuarve në sondazh, ata që kundërshtonin bashkimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE-në, ishin të prirur të kishin pikëpamje shumë më negative për vetë BE-në, sesa ata që e miratuan zgjerimin e BE-së në rajon. Një në dy 'kundërshtues' kanë një imazh tepër ose shumë negativ për BE-në. Në dallim me këta, afro dy të tretat e 'miratuesve' thanë se kanë një imazh mjaft ose shumë pozitiv për BE-në. Kjo të shtyn drejt përfundimit se për shumë njerëz në Francë, mendimi nëse Ballkani Perëndimor do t'i bashkohej BE-së, pasqyron pikëpamjet mbi BE-në në përgjithësi.

3. 'Pranuesit' dhe 'kundërshtuesit' kanë shqetësime të njëjta përsa i përket zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, por arrijnë në përfundime të ndryshme mbi aftësinë e BE-së për tu marrë me këto çështje.

Në thelb, ata që janë pro bashkimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE-në, besonin se BE-ja mund të përballet me sfidat që sjell zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht sfidat ekonomike, ndërsa ata kundër ishin më pak optimistë. Gjetjet më tej mbështesin përfundimin se pikëpamjet mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor janë pasqyrim i pikëpamjeve që njerëzit kanë mbi BE-në, kapacitetin e saj për të integruar shtete të reja anëtare dhe pasojat që këto do të sjellin për Francën.

4. Qeveria franceze duhet të jetë e vetëdijshme se për shumicën e qytetarëve, zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor nuk është një çështje e spikatur.

Nisur nga rëndësia e pakët e kësaj çështjeje mes votuesve francezë, ka pak gjasa që vazhdimësia e procesit të zgjerimit në Ballkanin Perëndimor të ketë një ndikim domethënës në politikën e brendshme franceze në përgjithësi dhe në procesin zgjedhor në veçanti. Frika se qeveria franceze mund të ndëshkohet nga elektorati për shtyrjen përpara të procesit të zgjerimit, nuk gjejnë bazë në këtë studim. Kjo nuk do të thotë se politikë-bërësit nuk duhet të jenë të kujdesshëm për mundësinë që njerëzit të ndihen sikur u është hequr e drejta për të vendosur mbi këtë çështje. Për shumë njerëz në Francë, zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor shoqërohet me shqetësime mbi kohezionin evropian, ndjenjat e mosbesimit brenda në BE si dhe mungesën e kontrollit.

5. Komunikimi mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor duhet të ofrojë siguri për ata me shqetësime të pashprehura si edhe të trajtojë shqetësimet e përgjithshme të votuesve francezë në lidhje me BE-në.

Nëse nuk trajtohen më parë shqetësimet më të përgjithshme që kanë njerëzit në lidhje me kohezionin evropian dhe të ardhmen e BE-së, zgjerimi i mëtejshëm i BE-së mund të shtojë një tjetër shtresë pakënaqësie në Francë ndaj sjelljeve të BE-së. Në planin afatgjatë, mënyra më e mirë për të ecur përpara është të krijohet një besim më i madh tek BE-ja, institucionet, rregullat e procedurat e saj, dhe të sigurohet që komunikimi mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor të mos nxisë pikëpamje negative mbi kohezionin evropian mes votuesve francezë. Kur është fjala për Ballkanin Perëndimor, argumentat abstrakte nuk kanë gjasa të ndikojnë në pikëpamjet e njerëzve, ndërsa përmirësimi i përvojave personale (siç janë mundësitë për turizëm) kanë potenciale pozitive.